



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS  
SË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**PËR VITIN 2019**

**Prishtinë, korrik 2020**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësja e ekipit Erëmira Bytyqi Pllana dhe anëtarët e ekipit Refiçe Morina dhe Leonora Hasani, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Blerim Kabashi.


## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore .....	7
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	8
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	18
Shtojca II: Letër Konfirmimi .....	21

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës (ZPRK) për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për këto Pasqyra. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



### Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore ishin përgatitur në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Në Pasqyrat Vjetore Financiare, ishin të nevojshme disa korrigjime financiare, të cilat pas vërejtjeve tona janë korrigjuar. Korrigjimët ishin bërë në këto pjesë të pasqyrave:

- Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit/Dalja e parasë së gatshme: Në kolonën Buxheti Fillestar, kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime, ishte prezantuar buxheti në shumë prej 2,696,000€, në vend se të prezantohet shuma prej 3,196,000€, si dhe
- Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit/Ndryshimet e autorizuara nga ligji; Kategoria e ndarjes/Mallra dhe shërbime: Në kolonën e ligjit të buxhetit, buxhetit përfundimtar në SIMFK, ishte prezantuar shuma 2,696,000€, në vend se të prezantohet shuma prej 3,196,000€.

Procesi i menaxhimit financiar dhe kontrollit ishte përcjellë me disa mangësi në fusha të caktuara, sikurse: shpenzimi i buxhetit në kategori jo adekuate, angazhimet e punonjësve jo në pajtim me rregulloret në fuqi, mos raportimi i përfituesve të subvencioneve, si dhe mangësitë në menaxhimin e pasurive.

Zbatimi i rekomandimeve nuk ishte në nivelin e duhur. Nga gjashtë (6) rekomandime sa ishin dhënë në vitin 2018, një (1) rekomandim ishte zbatuar, dy (2) ishin në proces dhe tre (3) nuk ishin adresuar ende.

## Opinion i Auditorit të Përgjithshëm<sup>1</sup>

### Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht, shih kapitullin<sup>1</sup> të këtij raporti.

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar së do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

---

<sup>1</sup> Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

---

## Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar.

---

# 1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PVF, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

## Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjektet e audituara. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ëbfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Falënderojmë menaxhmentin dhe stafin e ZPRK për bashkëpunim korrekt dhe ndihmën e ofruar gjatë procesit të auditimit.

## 2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Megjithatë, fushat ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë planifikimi i shpenzimeve në kategoritë përkatëse, zbatimi i rregullave lidhur me angazhimin e marrëveshjeve të veçanta, forcimi i kontrolleve mbi monitorimin e përfituesve të subvencioneve, si dhe menaxhimi i pasurisë.



## 2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela nr.1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>4,608,189</b>	<b>4,584,783</b>	<b>3,693,416</b>	<b>81%</b>	<b>3,256,583</b>	<b>2,168,142</b>
Granti i Qeverisë - Buxheti	4,608,189	4,584,524	3,693,416	81%	3,256,583	2,123,077
Donacionet e jashtme	0	259	0	0	0	45,065

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 259€. Kjo rritje është rezultat i donacionit të jashtëm nga Ambasada e Zvicrës në Kosovë, në mbështetje të Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Në vitin 2019, Zyra e Presidentit ka shpenzuar 81% të buxhetit final ose 3,693,416€, me një rritje në vlerë nominale prej 436,833€ krahasuar me vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>4,608,189</b>	<b>4,584,783</b>	<b>3,693,416</b>	<b>81%</b>	<b>3,256,583</b>	<b>2,168,142</b>
Pagat dhe Mëditjet	1,114,068	1,099,103	1,099,103	100%	1,012,301	890,002
Mallrat dhe Shërbimet	3,196,421	3,196,680	2,321,867	73%	1,961,786	1,203,130
Shërbimet komunale	12,700	4,000	3,836	96%	4,093	5,020
Subvencionet dhe Transferet	270,000	270,000	268,610	99%	264,800	69,990
Investimet Kapitale	15,000	15,000	0	0	13,603	0

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave (MF).

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 14,965€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë nr. 03/115 i datës 17.12.2019. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 1,099,103€;
- Buxheti për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 259€, si rezultat i donacionit të jashtëm. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 2,321,867€;
- Buxheti për shërbime komunale ishte zvogëluar për 8,700€ në raport me buxhetin fillestar, si rezultat i vendimit nr. 02/113 të datës 15.11.2019. Shpenzimi në këtë kategori ishte 3,836€; dhe
- Buxheti për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar nuk kishte pësuar ndryshime. Megjithatë, në këtë kategori nuk kishte shpenzim, pasi kontrata e planifikuar “Pajisje të TI për nevojat e Zyrës së Presidentit” ishte nënshkruar në fund të vitit 2019. Kjo për shkak të vonesave të kërkesave për iniciimin e procedurave.

### Çështja A1 Keq klasifikimi i shpenzimeve

**Gjetja** Sipas Rregullës Financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, shpenzimet duhet të regjistrohen sipas kodeve adekuate, të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për planin kontabël.

Pagesat në vlerë 19,789€, që kishin për qëllim realizimin e një busti, ishin bërë nga mallrat dhe shërbimet edhe pse ky projekt e kishte natyrën e shpenzimit kapital.

Kjo kishte ndodhur, pasi ky projekt nuk kishte qenë pjesë e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2019.

**Ndikimi** Pagesa e projekteve kapitale nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, reflekton duke nënvlerësuar investimet kapitale dhe mbivlerësuar mallrat dhe shërbimet.

**Rekomandimi A1** Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet planifikohen dhe realizohen nga kategoritë adekuate sipas natyrës së shpenzimit, bazuar në planin kontabël të aprovuar nga MF.

#### 2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2019 ishte 1,099,103€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 87 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 82. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar tre të rinj. Në këtë kategori kemi testuar 41 mostra për teste substanciale në vlerë 45,191€, si dhe 13 mostra për teste të pajtueshmërisë. Me rastin e ekzaminimeve tona, ka rezultuar çështja në vijim:

## Çështja B1 Të punësuarit me marrëveshje për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit dhe të angazhuar përtej afatit të lejuar ligjor

**Gjetja** Sipas Ligjit për Shërbimin Civil nr. 03/L-149, neni 12.4 - emërimet me afat të caktuar për një periudhë me të shkurtër se gjashtë (6) muaj bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta” (MSHV) të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet, dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtëzuar e rekrutimit.

- Nga tetë (8) raste të testuara, për të punësuarit me marrëveshje për shërbime të veçanta, në gjashtë (6) raste nuk ishin aplikuar procedura të thjeshtëzuara të rekrutimit, por angazhimi i tyre ishte bërë direkt përmes lidhjes së marrëveshjeve. Në tri nga këto raste, të punësuarit ishin angazhuar në pozita të rregullta, si: zyrtar i prokurimit, zyrtar për IT dhe përkthyes.
- Në pesë (5) raste për të angazhuarit me MSHV, ishin tejkaluar afatet e lejuara ligjore për angazhim, me ç`rast në dy (2) raste afati i angazhimit ishte tejkaluar për shtatë muaj, në dy raste tjera kishte tejkalim për tre muaj dhe një rast 20 ditë.

Angazhimi në pozita të rregullta dhe tejkalimi i afateve, kishte ndodhur si rezultat i mos plotësimit të kriterëve të kandidatëve nga konkuret e rregullta të shpallura nga ZPRK, me ç`rast gjatë vitit 2019, ishin anuluar tri konkurse, dhe si pasojë e pamundësisë për të shpallur konkurse të reja nga shtatori 2019, bazuar në shkresën e dërguar nga MAP/DASHC për ndërprerjen e tyre.

**Ndikimi** Angazhimi i nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta pa procedurë dhe në mungesë të transparencës, dëmton konkurrencën dhe rritë rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent për shërbimet e kërkuara. Ndërsa, angazhimi i tyre më gjatë se gjashtë muaj është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

**Rekomandimi B1** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se angazhimi i nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta, të bëhet vetëm pasi janë vlerësuar dhe arsyetuar nevojat për shërbimet specifike të tyre dhe, më pas, përmes zhvillimit të procedurave të kërkuara ligjore, si dhe duke respektuar afatin e lejuar ligjor për kohëzgjatjen e tyre.

### 2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 3,200,680€, dhe prej tyre ishin shpenzuar 2,325,703€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, furnizime për zyrë, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse dhe shërbimet komunale. Kemi testuar 65 mostra për teste substanciale në vlerë 1,207,380€ si dhe gjashtë (6) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Me rastin e ekzaminimeve tona, ne nuk kemi gjetur ndonjë parregullsi për t'u raportuar.

### 2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 270,000€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 268,610€. Ato kanë të bëjnë me projekte të ndryshme varësisht prej kërkesave nga personat fizik dhe juridik. Ne kemi testuar dhjetë (10) mostra për teste substanciale në vlerë 82,230€ si dhe nëntë (9) mostra për teste të pajtueshmërisë. Me rastin e ekzaminimeve tona, ka rezultuar çështja si në vijim:

#### Çështja A2 Mos raportimi i përfituesve të subvencioneve

**Gjetja** Bazuar në vendimin nr.23/2019, të datës 12.03.2019, të Sekretarit të Zyrës së Presidentit, për transferimin e mjeteve në vlerë 4,070€ ndaj OJQ-së përfituese lidhur me projektin për realizimin e një performancë live me artistë të huaj, pika 3 thekson se pas realizimit të projektit, përfituesi obligohet t'ia dorëzoj Zyrës së Presidentit raportin final me dëshmitë përkatëse, ndërsa pika 4 e këtij vendimi thekson se, në rast të mos realizimit të projektit, përfituesi obligohet për kthimin e mjeteve financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Zyra e Presidentit kishte lidhur marrëveshjen e bashkëpunimit me OJQ-në përfituese në vlerë 4,070€, më datë 12.03.2019, ndërkaq projekti ishte paraparë të realizohet brenda periudhës mars-maj 2019. OJQ, nuk kishte ofruar raportin final dhe dëshmitë përkatëse mbi realizimin e projektit të tyre.

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për subvencione, na ka ofruar dëshmitë se në mënyrë elektronike kishte kërkuar raportimin nga OJQ përfituese, mirëpo këta të fundit nuk janë përgjigjur.

**Ndikimi** Në mungesë të raporteve kthyesë nga përfituesit e subvencioneve, nuk është e mundur të konfirmohet nëse përfituesi ka shpenzuar fondet sipas qëllimit për të cilin është dhënë subvencioni.

**Rekomandimi A2** Sekretari i Përgjithshëm, të siguroj forcimin e kontrolleve në fushën e monitorimit të përfituesve të subvencioneve, për sigurimin e dëshmimeve përkatëse lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga përfituesit, ndërsa për mjetet e paarsyetuara, të sigurohet se merren masat e duhura të përcaktuara në vendim.

### 2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 15,000€, të cilat gjatë vitit 2019 nuk ishin shpenzuar.

## 2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 18,942€, pasurive jokapitale është 25,323€, si dhe e stoqeve 169,890€. Në këtë kategori, kemi testuar 10 mostra për teste substanciale në vlerë 18,823€, dhe shtatë (7) mostra për teste të pajtueshmërisë. Vlera e pasurive jokapitale në PFV është prezantuar nga regjistri i brendshëm që posedon Zyra e Presidentit për pasuritë jokapitale, pasi pasuritë e regjistruara në e-pasuri kanë qenë të mbivlerësuara për shkak të mos aplikimit të zhvlerësimit nga sistemi e-pasuria.

### Çështja A3 Pranimi i pasurive jo financiare pa komision të pranimit

**Gjetja** Bazuar në rregulloren mbi pasurinë jo financiare<sup>3</sup>, Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon komisionin për pranimin e pasurisë jofinanciare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë së pranuar, në përputhje me kontratën apo urdhërblertjen. Komisioni i pranimit duhet të jetë në përbërje jo më pak se tre anëtarë.

Në katër pagesa të testuara, pasuritë jofinanciare në vlerë 5,056€ ishin pranuar në mungesë të komisionit të pranimit.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e neglizhencës për të formuar komisione, pasi pasuritë të cilat janë pranuar janë konsideruar si vlera të vogla.

**Ndikimi** Pranimi i pasurive jofinanciare në mungesë të komisionit të pranimit, ndikon në pamundësinë e verifikimit të cilësisë, llojit, vlerës dhe sasisë së pasurisë dhe rrezikon pranimin e pasurive në mos përputhje me kontratën.

**Rekomandimi A3** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se me rastin e pranimit të pasurive jo financiare caktohet komisioni i pranimit prej jo më pak se tre anëtarë dhe çdo pasuri jo financiare pranohet nga komisioni i caktuar.

## 2.3 Detyrimet

### 2.3.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2019, ishte 24,563€. Ato kishin të bëjnë me dreka zyrtare, shpenzime të telefonisë mobile, derivate për automjete dhe shpenzimet e udhëtimeve zyrtare. Arsyeja e mos pagesës ishte për shkak të mbylljes së vitit fiskal. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Me rastin e ekzaminimeve tona, nuk kemi çështje për të raportuar.

<sup>3</sup> Rregullore MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, neni 8

---

### 2.3.2 Detyrimet kontingjente

Zyra e Presidentit nuk kishte detyrime kontingjente në fund të vitit 2019.

### 2.3.3 Detyrimet kontraktuese

Vlera e detyrimeve kontraktuese të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, që pritet të realizohen në vitet në periudhën 2020-2022 është 105,755€.

## 2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor. NjAB në përputhje me planin strategjik kishte përgatitur planin vjetor për vitin 2019, ku kishte planifikuar katër auditime të rregullta si dhe një auditim në rast se paraqitet me kërkesë të veçantë. Gjatë vitit 2019, kishte përfunduar dy auditime, prej të cilave njëri i planifikuar ndërsa një auditim me kërkesë. Përmes raporteve të auditimit, menaxhmentit i janë ofruar informata në lidhje me funksionimin e sistemit financiar dhe vlerësime për funksionimin dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme.

Komiteti i Auditimit kishte mbajtur tri takime gjatë vitit 2019. Në ato takime ishin vlerësuar dhe trajtuar çështjet e paraqitura në raportet e auditimit të brendshëm dhe adresimi i tyre nga institucioni.

Auditori i brendshëm (AB) kishte dhënë gjithsej shtatë (7) rekomandime, prej të cilave pesë (5) ishin zbatuar dhe dy (2) ishin zbatuar pjesërisht.

Fushat e mbuluara kishin të bëjnë me menaxhimin e buxhetit dhe shpenzimeve ndërsa periudhat mbulonin vitin 2018 dhe 2019.

---

### Çështja B2 Moszbatimi i planit vjetor të auditimit

#### Gjetja

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në planin vjetor kishte planifikuar katër auditime të rregullta si dhe një auditim në rast se paraqitet me kërkesë të veçantë, për vitin 2019. Nga ky plan, NJAB kishte arritur që të finalizojë vetëm dy auditime. Prej tyre njëri ka qenë me kërkesë të menaxhmentit për një kontratë lidhur me servisimin e automjeteve, dhe tjetri lidhur me menaxhimin e buxhetit dhe shpenzimeve të vitit 2019.

Sipas Auditorit të Brendshëm, kjo kishte ndodhur për shkak se ai ishte angazhuar në ofrimin e këshillave gjatë procesit të përgatitjes së PFV-ve dhe aktiviteteve/raporteve tjera në kuadër të institucionit.

**Ndikimi** Një plan i papërfunduar i NJAB, zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e kontrollit brendshëm. Kjo mund të rezultojë me dobësi të pidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive në monitorimin e kontrollit të brendshëm.

**Rekomandimi B2** Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurohet që NJAB është fokusuar në realizimin e planit të punës duke ndërmarrë veprime aktive në mënyrë që devijimet (ngecjet në plan) të adresohen në kohën e duhur.

### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV të vitit 2018 të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës ka rezultuar në gjashtë rekomandime kryesore. ZPRK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

ZPRK ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me 30 shtator sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, ndërsa për gjashtë-mujorin e dytë që është dashur të dorëzohet me 15 mars, është dorëzuar me vonesë, përkatësisht me 26 qershor.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, një rekomandim ishte zbatuar, dy ishin në proces dhe tre nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta planifikohen drejt dhe bëhen në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi.	Menaxhmenti nuk ka marrë veprime, pasi e njëjta gjendje është hasur gjatë vitit aktual.	Rekomandim i pazbatuar
2	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se në planin e prokurimit janë përfshirë të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët për t'u realizuar gjatë vitit fiskal, në mënyrë që njësitë kërkuese me kohë kanë identifikuar nevojat/kërkesat për prokurim.	Janë ndërmarrë veprime me ç`rast në raport me vitin kaluar ku 53% e procedurave ishin të paplanifikuara këtë vit kjo përqindje është 27%.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
3	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurohet që iniciimi i procedurave të prokurimit bëhet sipas planit të prokurimit dhe se procedurat e negociuara pa publikim përdoren vetëm në rastet e përcaktuara sipas LPP-së.	Nuk janë marrë veprime të duhura me ç`rast edhe këtë vit kemi hasur në gjetjen e natyrës së njëjtë.	Rekomandim i pazbatuar
4	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrole me rastin e ndarjes së detyrave në mënyrë që kjo të bëhet në pajtim me kërkesat e udhëzuesit operativ të prokurimit për të parandaluar rastet e tilla.	Gjatë testimeve tona, nuk kemi hasur në raste të tilla.	Rekomandim i zbatuar
5	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që në bashkëpunim me MAP-in të vë në funksion sistemi e-pasuria për të mundësuar raportimin e pasurisë jo kapitale nën 1,000€ në PFV sipas kërkesave për raportim financiar.	Janë marra masa me ç`rast pasuritë jokapitale janë bartur në sistemin e-pasuria megjithatë raportimi nuk është bërë nga ky softuer për shkak të mos aplikimit të zhvlerësimit të saktë të pasurive.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar



6	Sistemi i auditimit të brendshëm	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurohet që NJAB është fokusuar në realizimin e planit të punës duke ndërmarr veprime aktive në mënyrë që devijimet (ngecjet në plan) të adresohen në kohën e duhur.	Nuk janë marrë masa, me ç`rast edhe këtë vit plani i punës ka pasur ngecje në realizim.	Rekomandim i pazbatuar
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
A1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet planifikohen dhe realizohen nga kategoritë adekuate sipas natyrës së shpenzimit, bazuar në planin kontabël të aprovuar nga MF.		
B1	Pagat dhe mëditjet.	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se angazhimi i nëpunësve me marrëveshje për shërbime të veçanta, të bëhet vetëm pasi janë vlerësuar dhe arsyetuar nevojat për shërbimet specifike të tyre dhe më pas përmes zhvillimit të procedurave të kërkuara ligjore, si dhe duke respektuar afatin e lejuar ligjor për kohëzgjatjen e tyre.		
A2	Subvencionet dhe transferet.	Sekretari i Përgjithshëm, të siguroj forcimin e kontroleve në fushën e monitorimit të përfituesve të subvencioneve, për sigurimin e dëshmimeve përkatëse lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga përfituesit, ndërsa për mjetet e paarsyetuara, të sigurohet se merren masat e duhura të përcaktuara në vendim.		
A3	Pasuritë kapitale dhe jokapitale.	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se me rastin e pranimit të pasurive jo financiarë caktohet komisioni i pranimit prej jo më pak se tre anëtarë dhe çdo pasuri jo financiarë pranohet nga komisioni i caktuar.		
B3	Funksioni i auditimit të brendshëm.	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurohet që NJAB është fokusuar në realizimin e planit të punës duke ndërmarrë veprime aktive në mënyrë që devijimet (ngecjet në plan) të adresohen në kohën e duhur.		

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër Konfirmimi

RE PUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
KODI I IDENTIFIKIMIT CLASSIFICATION CODE			
Kategoria Org. Org. Unit	Shifri Klasifikim Class. Code	Nr. Prot. Prot. No.	Nr. i faqëve No. Pages
05	47	1204	1



RE PUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA E PRESIDENTIT - URBETI PRESIDENTIAL - OFFICE OF THE PRESIDENT	
Nr. Prot. Prot. No.	Data Date
724/1	20.07.2020
PRISHTINE/A	

REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT

REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT

REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PRESDENIKA

SEKRETARI I ZYRËS - SECRETARY OF THE OFFICE - SEKRETAR KANCELARIJE

**LETËR E KONFIRMIMIT**

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Zyrës së Presidentit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Driton Gashi



Sekretar i Përgjithshëm – Zyra e Presidentit,

Data: 22.Korrik.2020, Prishtinë,